

VENDIM
Nr. 36, datë 10.2.2025

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË BLERJES
SË ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PRODHUESIT EKZISTUES
ME PËRPARËSI NGA BURIMET FOTOVOLTAIKE DHE EOLIKE PËR VITIN 2024**

Në mbështetje të neneve 10, pika 5, 29, pika 1, dhe 31, pika 2, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”; dhe neneve 15 dhe 19, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 998 prot., datë 6.2.2025 nga Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme dhe Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike për vitin 2024”,

Konstatoi se:

- Bazuar në pikën 5, të nenit 10, të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE ngarkohet me detyrimin për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike dhe eolike në përputhje me metodologjinë e miratuar nga Këshilli i Ministrave, e cila duhet të ketë të përcaktuara kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- Mbështetur në pikën 37 të nenit 3 të ligjit nr. 24/2023, “Prodhues ekzistues me përparësi” është një prodhues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji ka nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues fotovoltaike deri në 2 mw, eolik deri në 3 mw dhe për hidrocentrale me kapacitet të instaluar deri 15 mw.

- Mbështetur në pikën 2 të nenit 31, aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të ligjit nr. 7/2017, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, të ndryshuar, vazhdojnë të mbeten në fuqi dhe të zbatohen deri në momentin e miratimit të akteve nënligjore në zbatim të këtij ligji. Në këto kushte, metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369/2017, vijon të mbetet në fuqi dhe do të shërbejë për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike nga burimet e vogla të rinovueshme, nga dielli deri në 2 mw dhe era deri në 3 mw për prodhuesit ekzistues me përparësi që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose është pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues.

- VKM nr. 369, datë 26.4.2017, “Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era”, në pikën 2 të saj, ngarkon ERE-n me detyrimin për miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e vogla të rinovueshme nga dielli dhe era, në përputhje me çmimin e mesatarizuar për vitin 2017, sipas parashikimeve të kësaj Metodologjie, bazuar në referencat e tabelës së paraqitur në këtë VKM për sa i takon LCOE dhe WACC ose të dhënave konkrete të kostove të investimeve që mund të sigurohen për vitet në vijim.

- Metodologjia e miratuar me VKM-në nr. 369, datë 26.4.2017 përcakton kriteret e llogaritjes së çmimit, duke u bazuar në kthimin e arsyeshëm të vlerës së investimeve, sipas llojit të teknologjisë së përdorur.

- ERE me fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuesve ekzistues me përparësi do t'i drejtohet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për informacion lidhur me subjektet të cilët që në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë nënshkruar një kontratë për zhvillim projekti me ministrinë ose janë pajisur me miratim paraprak për ndërtimin e kapacitetit prodhues. Ky informacion do të shërbejë për vlerësimin dhe shqyrtimin e të dhënave

të nevojshme për llogaritjen e çmimeve për teknologjitë në fjalë, mbështetur në përcaktimet e legjislationit në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për përcaktimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike të prodhuar prej prodhuesve ekzistues me përparësi nga burimet fotovoltaike deri në 2 mw dhe eolike deri në 3 mw për vitin 2024.

2. Drejtoria e Zhvillimit të Politikave dhe Mbikëqyrjes së Burimeve të Rinovueshme të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund ti kërkojë ERE-s brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti